



**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMIVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E QENDRES SPITALORE RAJONALE BERAT**

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, TERMAT E
REFERENCES DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Pajisje Mjekësore me 2 lote”:

Loti 1: "Blerje Aparat ECHO".

Loti 2: “Blerje pajisje mjekësore "Kullë Laparoskopike Endoskopike”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje mjekësore – 33100000-1

Argumentimi: Në bazë të nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 I ndryshuar “Për prokurimin publik”, nenit 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2/c dhe nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Rajonale Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentim: Bazuar në kërkesen me specifikimet përkatëse nga Specialisti Biomedical miratuar nga Drejtoria e QSRB për “Blerje Aparat ECHO” me Nr.4484 Prot., datë 06.09.2024 dhe është ri-përlllogaritur fondi limit me shkresën Nr.4929 Prot., datë 25.09.2024, bazuar në kërkesën e AK-së për rimiratim përdorim fondi nga të ardhurat dytësore për "Blerje Aparat ECHO" me Nr. 5070 Prot, datë 01.10.2024, Miratim shpenzimesh nga të ardhurat dytësore për vitn 2024 nga MSHMS me Nr.17/329 Prot., datë 08.10.2024, protokolluar këtu me Nr. 5273 Prot., datë 10.10.2024, bazuar në kërkesën me specifikimet përkatëse nga Specialisti Biomedical miratuar nga Drejtoria e QSRB për “Blerje pajisje mjekësore "Kullë Laparoskopike Endoskopike” me Nr. 5125 Prot., datë 02.10.2024, bazuar në përlllogaritjen e fondit limit me shkresën Nr. 5393 Prot., datë 18.10.2024, bazuar në kërkesën e AK-së për miratim përdorim fondi nga të ardhurat dytësore për "Blerje pajisje mjekësore "Kullë Laparoskopike Endoskopike " me Nr. 5404 Prot, datë 18.10.2024, Miratim

shpenzimesh nga të ardhurat dytësore për vitn 2024 nga MSHMS me Nr. 17/351 Prot., datë 24.10.2024, protokolluar këtu me Nr. 5545 Prot., datë 10.10.2024,

Fondi limit: Fondi limit: 10,883,333 (*dhjete million e teteqind e tetedhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre leke pa tvsh.*)

Loti 1: "Blerje Aparat ECHO" me fond limit: 2,580,000 (dy milion e peseqinde e tetedhjetë mijë) leke pa TVSH

Loti 2: "Blerje pajisje mjekësore: "Kullë Laparoskopike Endoskopike" me fond limit: 8,303,333

(tete milion e treqind e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH

Argumentimi: Përlllogaritja e fondit limit është dokumentuar nga komisioni i argumentimit të përlllogaritjes së fondit limit të procedurës me përlllogaritjes së fondit limit me Nr.4929 Prot., datë 25.09.2024, Nr. 5393 Prot., datë 18.10.2024, *bazuar ne nenet 34" Perlllogaritja e vleres se parashikuar te prokurimit",35 "Studim paraprak I tregut" te ligjit Nr. 162/2020 I ndryshuar dhe, 76 "Menyrat per perlllogaritjen e vleres se prokurimit" pika 1/b e VKM_RPP_285_19.05.2021e ndryshuar*

Argumentim: Procedure e Hapur Mallra -Në mbështetje të Nenit 33-Kufijtë monetarë pika 1- b) kufiri i ulët monetary, Neni 41-Procedurat standarde të prokurimit pika 1-a) procedurë e hapur, Neni 42 - Procedurë e hapur të ligjit Nr. 162/2020 datë 23/12/2020 te ndryshuar "Për Prokurimin Publik", Neni 42-Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote, Neni 11-Kufijtë monetarë, Neni 46 -Llojet e procedurave të prokurimit pika 2- b-procedurë e hapur, Neni 47-Procedura e hapur, Neni 115-Udhëzime dhe manualët shpjeguese ne VKM_RPP_285_19.05.2021 per " Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, Vendimin Nr. 291 date 15.05.2024 Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Te njejta per te dyja Lotet

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit dhe kërkesat e pikës 1 (gërmat a / b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit janë parashikuar pa ndryshime, sipas formatit të dokumenteve standarde të tenderit të publikuara nga APP, dhe vendosja e tyre është bazuar në nenet 76 “**Kriteret detyruese për skualifikim**”, 82 “**Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit**” dhe 83 “**Sigurimi i ofertës**” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik I ndryshuar, nenit 26 “**Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit**”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Loti 1: "Blerje Aparat ECHO" në vlerën: 51 600 (pesedhjetë e një mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH

Loti 2: “Blerje pajisje mjekësore: "Kullë Laparoskopike Endoskopike” në vlerën: 166,066.66

(njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e gjashtë) leke pa TVSH

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik I ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 “**Kërkesat për kualifikim**” të Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik” I ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuara se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Per paisjet mjekësore” I ndryshuar*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit ose shumës së loteve për të cilat konkurren operatorit.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar të vlerës së fondit limit të lotit ose shumës së loteve për të cilën ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “ Përshkrimi i shkurtër I Loteve” në pikën 2.14.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar ku përcaktohet: Neni 43 pika 2/b **Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Dëshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se 40% te vleres së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontraten, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontraten e furnizimit, ose/dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.”*

b) *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore te shitjes, te plotësuara sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore ku te shënohen datat, shumat dhe sasite e furnizimeve te realizuara .*

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar të vlerës së fondit limit te lotit ose shumes se loteve për të cilen ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “ Përshkrimi i shkurtër i Loteve” ne piken 2.14.

Faturat të jenë të deklaruar në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 4 te nenti 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar ne te cilen gjejme te përcaktuar se : pika 4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 ne te cilen eshte përcaktuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar. ne te cilen eshte përcaktuar: pika 4 *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë per aftesine e tyre teknike nepermjet përvojave te duhura qe jane ne perpjestim me natyren e objektit te prokurimit për zbatimin e kontratës. Per kete është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.**

2.3.2- Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e vet te pakten 1 (nje) Ing. Biomedical ose informatik ose

elektronik ose fusha te ngjashme te certifikuar ose trajnuar per instalimin dhe servis pajisjesh mjekesore objekt prokurimi, te vertetuar me diplomen perkatese/certifikaten trajnimit/deshmi te formimit profesional si dhe ekuivalentet e ketyre certifikimeve leshuar nga autoritetet te autorizuar/certifikuara per dhenine e tyre dhe jo vetem nga prodhues, CV-ne, kontraten individuale te vlefshme te punes ne ditet e hapjes se ofertave.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij nje Ing. biomedical/informatik/elektronik ose fusha te ngjashme te certifikuar/trajnuar per instalimin dhe servis pajisjesh mjekesore objekt prokurimi është vendosur në funksion të realizimit të kontrates.

Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshetje te Rekomandimit nr. 5168 prot. Date 18.07.2024 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik

Specialisti mund të jetë i çertifikuar nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar/ çertifikuar për lëshuar çertifikata/dëshmi trajnimi/kualifikimi për pajisjen objekt prokurimi ose ekuivalente, kjo me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësin është i nevojshëm për të provuar që është i pajisur me çertifikate/çdo dokument tjetër që të vërtetojë trajnimin/kualifikimin për pajisjet objekt prokurimi

2.3.3. Për artikullin e ofertuar te paraqitet katalogu i prodhuesit, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen).

Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit)te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikën 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar në nenin 40, pika 6) germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë duhet te demonstrojne nepermjet katalogeve te aparaturave/pajisjeve qe ofrojne, specifikimet teknike konkrete, te markuara. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Specifikimet teknike te aparaturave/pajisjeve te markuara sherbejne si baze vleresimi nga KVO gjate shqyrtimit te ofertave teknike te OE per aparaturate/pajisjet e ofertuara.

Kërkesa për katalogun siguron disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara. Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga

Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese:

a) certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” sipas konformitetit me standartet europiane- e vlefshme, ose nese operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekesore duhet të paraqese certifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore” me objekt aktiviteti të certifikates per tregetim të materialeve/paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqese autodeklarate** që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilesise **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” sipas konformitetit me standartet europiane- e vlefshme oseduhet të paraqese certifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilesise per Paisjet Mjekesore” me objekt aktiviteti të certifikates per tregetim të materialeve/paisjeve mjekësore në përputhje me në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vleresimit të dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqese certifikatën në fjalë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, kriteri i siperpermendur plotësohet nga të gjithë operatorët ekonomik se bashku.

Certifikatat duhet të jene të vlefshme dhe të leshuara nga nje organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga RSH.

Argumentimi: Ky kriter i percaktuar në pikën a) dhe b) është vendosur në përputhje me nenin 77, pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” I ndryshuar, në të cilën gjejmë të percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1,3,4 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar ku percaktohet se: pika 1 të nenit 44. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Pika 3 të nenit 44 Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit. Pika 4 të nenit 44 Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

ISO 9001:2015 - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë". ISO 9001:2015, sipas objektit të prokurimit, specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë: • duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme. • synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme. Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 9001: 2015 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij

EN ISO 13485:2016 – Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë së Pajisjeve Mjekësore, EN ISO 13485:2016 specifikon kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë për kompanitë aktive në projektimin, prodhimin, shitjen, instalimin dhe shërbimin e pajisjeve mjekësore. Vë theks të veçantë në menaxhimin e riskut dhe vendimmarrjen bazuar në risqet e përfshira në proceset që nuk kanë të bëjnë me zbatimin e produktit. Përqendrohet në rreziqet që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat rregullatore. Kërkon që organizatat të kryejnë kontrole më të rrepta në rastet kur kanë procese të kontraktuara, duke zbatuar marrëveshje me shkrim për vlerësimin e furnitorëve të tyre në bazë të riskut. Përgjigjet ndaj kërkesave rregullatore në rritje për organizatat në të gjithë zinxhirin e furnizimit të pajisjeve mjekësore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se se mallrat, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertues vetë paraqesin certifikata të lëshuara në përputhje me objektin e prokurimit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për cilësinë e produkteve që do të furnizojnë dhe garancinë e tyre sipas normativave standarte.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të vetdeklarojë se pajisjet do të jenë të shoqëruara me manualin e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/shërbimit.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës.

Manuali I përdorimit është një ndër elementët kryesor që ka të bashkëngjitur produkti dhe mund të relativizohet si fjalori për një gjuhë të huaj. Për vetë përmbajtjen e tij, pajisja nuk mund të vijë pa manualin e përdorimit sepse përdorimi I tij është jetësor në vënien në funksionim në mënyrën e duhur dhe eficientë pajisjen. Ato përmbajnë në mënyrë të specifikuar gjithë funksionet e pajisjes si ato hardware ashtu edhe software (programimin e saj). Kanë të shpjeguar në detaje mënyrën sesi përdoret një specifikë e veçantë e pajisjes apo mekanizma për situatë të vecanta.

Me zhvillimin e teknologjise dhe me automatizimin e industrisë, proceset thjeshtësohen më shumë, por programimi i tyre bëhet më i komplikuar, për këtë arsye, për një përdorim sa më efikas të pajisjeve dhe njëkohësisht të sigurtë, nevojitet manuali i përdorimit të saj. Duke qënë se pajisjet kanë tendencën të bëhen multifunksionale, për vënien në përdorim të të gjitha funksioneve, është e nevojshme konsultimi me manualin e përdorimit. Në asnjë moment nuk mund të pretendojmë se informacionet për përdorimin e një pajisjeje mund ti gjejmë në internet më specifike se në manualin e saj të përdorimit që është unik për çdo pajisje.

Duke marrë parasysh që në referim kemi pajisje që përdoren në mjekësi dhe drejtpërdrejtë me pacientin, përdorimi i tyre duhet të bëhet në kushte shumë të larta sigurie dhe peciziteti, për këtë në punën tonë të përditshme na ndihmon manuali, si një pasaportë sigurie në përdorimin e tij që informon saktësisht përdoruesit për mënyrën e përdorimit të sigurt të produktit dhe paralajmëron për çdo rrezik të mundshëm të abuzimit të tij, në këtë mënyrë shmangim çdo rast rreziku potencial. Bazuar edhe në :Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri 3.4.5 Prokurimi i materialeve të konsumit, i pjesëve aksesore dhe i pjesëve të këmbimit.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen/artikullin e kërkuar bashkë me aksesoret përkatës në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet përkatëse për produktet.

Argumentimi: kërkesat e kësaj pike lidhen me verifikimet e metejshme që kanë të bëjnë me marrjen në dorezim të mallit (për OE fitues) nga AK. Të gjitha kërkesat e kësaj pike, perfshi dhe çertifikimet, janë kërkesa që duhet të shoqërojnë aparaturat/pajisjet mjekësore.

Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:

